

OPINION REFLEKSIONE UNIVERSITARE

Shqiptarët në të dy anët e kufirit, duke qenë të robëruar me shekuj, bëri që gjuha e shkruar e tyre nëpër shkolla të jetë relativisht e re. Shih, për këtë, shkolla dhe shkollimi për ne konsiderohen të shenjta.

Universiteti i Prishtinës (UP) u themelua në vitin 1970, në mbështetje të një plejade njerëzish mendjendritur, vizionarë, epoka e të cilëve u administrua me rendiment të lartë. Se çfarë përfaqësonte themelimi i UP, për kohën, më së miri mund të kuptohet nga thënia e perfrazuar e dalë nga “goja e ish regjimit”: **”Ne shqiptarëve iu morëm pushkët, por iu dhuruam topat”!** **”Topat e diturisë” u vendosën në të katër anët e “kalasë”, ku u ngritë tempulli më i lartë i shkencës i cili quhet UNIVERSITET.**

40 vitet e ekzistimit të Universitetit të Prishtinës (UP), “natyrshëm” janë të ndara në 4 harqe kohore (1970-1980); (1980-1990); (1990-2000) dhe (2000-2010), ku heq periudhën e parë dhe të dytë kohore, kur ishte arritur “zeniti” i krijimtarisë dhe i vlerave të mirëfillta shkencore, dy të tjerat, njëra më pak e tjetra më shumë, hapën “plagë” në trupin e shëndoshë të tij.

UP (një kohë i emërtuar Universiteti i Kosovës) do të thoshim deri në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar duhet të krenohet me të kaluarën dhe me kuadrot që ka nxjerrë, prej të cilëve disa mijëra vetash “kanë krijuar emër”, puna dhe vepra e të cilëve paraqesin kontribut të rëndësishëm për mendimin shkencor në Kosovë dhe më gjerë, duke nderuar në këtë mënyrë edhe kombin. Këta kohës së vet mjaftë i kanë thënë dhe mjaftë i kanë dhënë.

Kuadrot mësimore-shkencore të “deridjeshëm” ishin garanci e mjaftuar që “jo çdo student i regjistruar do të duhej të diplomojë”! Ajo që ka mbetur në “kujtesën historike” ishte: Recensionet shkencore (për zgjedhje kuadrosh) të lëshuara nga mësimdhënësit eminentë të lëmit përkatës, “lënin jashtë dymet të Universitetit” shumë “shkencëtarë” goxha “të leshur”, meqë nga “vëzhgimet” që bënin rezultonte që iu mungonin “tiparet profesionale dhe morale” ose “kishin pengesa në të folur”, ose “nuk dinin të flisnin dhe të komunikonin”, ose “ishin në dimrin e jetës së tyre”, ose “nuk dinin të lexonin para se të kishin lindur”, ose “nuk mbanin kollare”, ose “nuk e kishin të botuar asnjë punim profesional.”...! Ngritja me tituj shkencorë dhe profesionalë ishte e admirueshme.

Edhe pse harku kohor (1990-2000) numëron “vitet e mbijetesës” të Arsimit Universitar në Kosovë, megjithatë janë për t’u vlerësuar disa parametra pozitivë:

- botimi i librave universitarë;
- arritja e “natyrshme” e titujve shkencorë e profesionalë dhe
- “ngjirje e përkohshme” për ta rifreskuar personelin mësimor-shkencor.

Menjëherë pas Luftës në Rektorat ndodhi “kthesa”. ”Dhanë dorëheqje” personeli udhëheqës, i cili pati guximin të dalë para tankeve, në mbrojtje të shkollimit shqip të “burgosur”! Për kohën dhe rrethanat kur ndodhi “kthesa” poeti shkroi:

“ U nxi koha ,u zu Dielli,
Lot të zjarrtë , lëshonte qielli”!

Një aforizëm i moçëm na mëson: “Nuk është mirë të ndërrohen kuajt e karrocës që gjendet në mes të lumit dhe në mes të dimrit”!

“Ish udhëheqja” kaloi në “kujtesën historike të brezave”, për faktin se ata, vërtetë dinin “të flisnin”, “të shkruanin” dhe “të vepronin”, përkundër “kamxhikut” i cili jo rrallëherë “i u ledhatoi trupin”!

Për UP është shkruar dhe analizuar me dhjetëra herë në shtypin e përditshëm, në veçanti gjatë viteve 2005, 2006 e 2007 dhe këto shkrime nga penat eminente redaktoriale të gazetarisë sonë, prej të cilave janë “huazuar” disa “mes rreshta”. Nuk e kam të ditur që atëbotë ka pasur reagime apo “veprime” nga ndonjë ish zyrtar i Universitetit.

UP është hallemadh, të cilat të shtresuara dhe të trashëguara gjatë viteve, jo që janë zgjidhur, por janë shumëfishuar:

1. Ndërhyrja e politikës në Universitet dhe politizimi i Arsimit të Lartë;
2. Mungesë e autonomisë në menaxhim-financiar dhe e mekanizmave për llogaridhënie lidhur me cilësinë në mësimdhënie si dhe “pengesat e shumëfishuara” për ta botuar librin universitarë;
3. “Fenomeni” shumë i përforur i plagjiaturave dhe “shitje-falje” e titujve shkencorë;
4. “Plakja” e kuadrit mësimdhënës dhe zëvendësimi i tyre me “doktorë shkencash”, të cilët ende “nuk kanë filluar të mësojnë”;
5. Liberalizimi i sistemit të vlerësimit dhe mundësia e diplomimit të çdo personi që regjistron fakultetin (“pushteti i notës” i komprometuar);
6. Zhargitja 40 vjeçare për ta themeluar Universitetin e Mjekësisë;
7. Reforma e mirëfilltë akademike mbetet për t’u dëshiruar! (Reforma është kuptuar: “Pajisje” e të gjithë mësimdhënësve universitarë me gradën shkencore “dr.sc”, edhe ata të “paraushtarakut”, duke i profilizuar për “edukatë qytetare”! **Do të duhej më shumë se një doktoratë nga UP apo universitetet tjera simotra të Ballkanit Perëndimor, për të qenë ligjërues!.**)

• “Partitë politike të të gjithë krahëve synojnë kontrollin mbi Universitetin jo për emër dhe nam, por interesa shumë pragmatike, të regjistrojnë studentë ke të duan dhe sa të duan, të ndajnë diploma dhe tituj shkencor pa asnjë kriter, të bëjnë avancime në tituj shkencor e profesional sipas përkatësive partiake, të zgjedhin dekanë e senatorë po sipas kësaj përkatësie.” (Koha Ditore, 06.05.2006)

Po qe se analizojmë “rrjedhat” e UP pas vitit 2000, kur nëpërmjet “kthesës” është instaluar “mendësi jodemokratike”, rëndësi përcaktuese kishte “administratori” në cilësinë e “Pashait”, qëndrimet e të cilit na janë të njohura:

(1) “Humbje e vendeve të punës për një numër të konsiderueshëm të mësimdhënësve- është një nga pjesët e Reformës “(Koha Ditore, 02.05.2000)

(2) “Do të largohen nga procesi i mësimdhënies persona të pakualifikuar” (Koha Ditore 13.10.2000)

Kështu nga “të shkruarit e shkencës në libra” u kalua në “pajisjen me doktoratura”, sepse përndryshe “rrezikohej vendi i punës”. Për të qenë situata akoma më e nderë: “U nënshkruan 90 vendimet e para për profesorët dhe asistentët që do të shkojnë nga UP” (Zëri, 16.01.2002) Njerëzit e të gjitha shtresave ishin shumë “kureshtarë” të dinin për “fatin” e personave të cilët “aksidentalisht” kishin mbetur pa tituj shkencorë, ndërsa “ata ishin vetë shkenca”!

Kështu filloi “lufta për ekzistencë”, “të jesh” apo “mos të jesh”. Po këtu duhet kërkuar dhe gjetur njërin nga shkaqet e degradimit të UP, pasojat e të cilit janë të prekshme sot.

“Fenomeni e të shkruarit për llogari të tjetërkujt nga letërsia është përhapur në monografi dhe memoare, madje edhe në tema magistrature dhe disertacionesh”. (Koha Ditore, 16.05.2005)

Për t'u mbrojtur nga "fshesa e Hamurabit" filloi "mbrojtja e disertacioneve" si të ishin "tema mature", të punuara edhe nga "bedelët", disa edhe me tema" të dyshimta "dhe aso "të përsëritura", meqë u konfirmua nëpërmjet shtypit: "UP nuk i kontrollon doktoratat e dyshimta". **(Koha Ditore, 27.05.2005)**

"Rastisën "mbrojtjet e disertacioneve nën petkun "konflikt interesi":

- në "mesnatë";
- natën e Vitit Ri;
- në moshën 64 vjeçare;
- ku mentor ishte "burri i nënës";
- ku mentor ishte "djali i babës"
- ku prezentë ishin "tri veta dhe një njeri"....

Nuk duhet harruar edhe "truallin e përshtatshëm " në vendet fqinje !

- "Plagjiatorët jo që janë ndëshkuar dhe mbetur pa tituj, por zakonisht kanë avancuar në postet drejtuese dhe përgjegjëse të fakulteteve dhe Universitetit". **(Koha Ditore, 13.06.2001)**

"Plagjiaturat janë fenomeni më i përfolur dhe në opinion është krijuar ideja se në UP dhe gjithandej botës akademike nuk bëhet gjë tjetër përveç se vidhet në shkencë dhe abuzohet me procesin mësimor." **(Koha Ditore, 9.12.2006)**

"Askush nuk ka besuar se vjedhja e pronës intelektuale në UP mund të kishte marrë përmasa të këtilla. Madje shumë njerëz nuk i besojnë këtij fakti . Si është e mundur se njerëzit e shkencës abuzojnë aq lehtë, se punojnë aq pak, se aq lehtë shkelin mbi ligjet". **(Koha Ditore, 17.03.2007)**

"Është proces i dhimbshëm edhe për ata njerëz të UP që me shumë sakrificë kanë provuar të ruajnë integritetin moral dhe profesional. Të tillë ka doemos, por në degradim të përgjithshëm ata duken specie të rralla, madje jo shumë të besueshme për këtë realitet". **(Koha Ditore, 17.03.2007)**

Tani si të zgjidhet kjo "fije lëmshi", **si ta ndajmë "me letra", të diturin nga i padituri, vlerën nga antivlera, pedagogun nga demagogu**, kur dihet që "ajo çfarë falet nuk merret"! Si ndodhi që "doktori me emër", me dorën e tij ka firmosë "gradën shkencore" të kolegut, të cilën edhe familjarët e tij e vështrojnë me dyshim?!

Në këtë mes shoqëror **kush është i "pafajshëm", "ai që shiti titull"; "ai që e bleu titullin", apo "ai që fali titull"**? Gjithnjë ka pasur avancime "jo meritorë" në tituj profesional, por këto të "fundit" i kanë venë "kapak". Në moshën 64 vjeçare doktoruan dhe pa e shkruar asnjë libër të mirëfilltë dhe pa qenë asnjëherë "mentor", në "vigjilje" të "pensionimit" , "vetëtimthi" fituan gradën "prof inordinar", për të punuar me pagë mujore deri në moshën 70 vjeçare!. Personat të cilët deri dje ishin shumë të zëshëm kundër kësaj dukurie, sot janë edhe vetë bartës të saj!

- Mësimdhënësit, një pjesë jo e vogël e tyre, të të gjitha fakulteteve, mbështetur nga personeli drejtues i tyre, kanë gjetur **"honorarë të përjetshëm"** (duke "mbuluar" edhe dy e më tepër vende pune, me tre-katër "kurse" të një dege në fakultet!). "Harruan" me përtërirë personelin mësimdhënës me kuadro të reja, të shkolluara edhe në Perëndim.

Mësimdhënësit universitarë nuk bëjnë punën e “argatit në bujqësi”!! Asnjëherë “nuk janë gjetur” brenda “natës”, ”kur të duash” dhe “sa ë duash”?! Me keqardhje konstatojnë që **“mësimdhënësit e UP janë plakur”!** Përndryshe po këtyre mësimdhënësve **“iu humbi stilolapsi dhe harruan të shkruajnë”!** Në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar është kërkuar me ngulm: **”Në UP nuk ka vend asnjë mësimdhënës i cili nuk shkruan për studentët e tij një libër apo një dispensë”.** Demagogët aktualë arsyetohen me faktin që “ndihmesën e librit”, sot e ofron Interneti. Megjithatë kjo paraqet vetëm një pjesë të së vërtetës!

- Vlerësimi i mirëfilltë i njohurive në arsimin parauniversitar tek ne në Kosovë pësoi goditje të rëndë që në dekadën e shtatë të shekullit të kaluar (1963) nëpërmjet dyshit (2) “famëkeq”.

Për shkak të këtij liberalizimi kemi “vjelë faljen masive të notave”, duke lëshuar në këtë mënyrë edhe dëftesa, si të ishin “bileta autobusi”!

Sot pas një gjysmë shekulli, në të tre shkallët e shkollimit formal; fillor (1-5), të mesëm të ultë (6-9) dhe të mesëm të lartë (10-12), të thuash, nxënësit nuk mund të shpallën si mbetës dhe nuk bën të përsërisin klasën!

Shkarazi e përmendëm vlerësimin në arsimin parauniversitar për të reflektuar:

Sistemi i shkollimit në njëfarë kuptimi i ngjanë “një piramide shumëfaqesore me pozitë të përmbysur” dhe “sa më herët të dëmtohet kulmi”, “aq më të rënda janë pasojat për bazën”. E “përkthyer “, kjo do të thotë, “baza “ e kësaj piramide është Arsimi Universitar.

“Pushteti i notës” në UP, gjatë periudhës kohore 40 vjeçare veçohet me dy epoka

- **Njëzetë vitet e parë (1970-1990)** padyshim karakterizohen nga “ashpërsia” e sistemit të vlerësimit. Megjithatë kjo njihet si **“epoka e artë”.**

Të thuash, çdo i ri apo e re me shkollë të mesme të kryer, e ka provuar të jetë regjistruar në ndonjërin nga degët e fakulteteve ekzistuese (të gjithë fitonin bursë apo kredi!). Por pjesa më e madhe e tyre, pas një viti ka braktisur njëherë e përgjithmonë studimet në shkollën e lartë! Këtu komenti është një tepri!

Para viteve ’90 edhe në studimet e magjistraturës ekzistonte një “hendek” tek titujt shkencorë “mr .sc.” dhe “dr. sc“. Numër i konsiderueshëm “magjistrash” shkonin në pension me po atë gradë shkencore sepse e “dyta” jepej me “miligramë”. Në vitin 2010 patëm “mbrojtje të disertacionit” edhe në moshën 69 vjeçare!

- **Njëzetë vitet e dytë (1990-2000)** karakterizohen si **“epoka gri”** e veprimtarisë së UP. Fillimisht, harku kohor (1990-2000) numëron “vitet e mbijetesës” të UP dhe po atëherë në emër të “patriotizmit” u shfaqen “shenjat e para” të një vlerësimi “më liberal”, për të arritur sot të thuash, deri tek “ liberalizimi i skajshëm” në të vlerësuar, i cili “mundëson” diplomimin me “çdo kusht” dhe me “çdo çmim”, të thuash të çdo personi që regjistron fakultetin! Edhe pse e hidhur kjo është e vërteta!

E trajtuam këtë dukuri të shëmtuar dhe me pasoja duke shpresuar që shqiptarët si komb “duke kthyer fytyrën nga Perëndimi” do të kenë rast t’i thonë “stop” diturisë formale, jocilësore dhe “të fituar pa djersë”, meqë ajo herët a vonë do të na rikthehet si bumerang.

- Gjithkund në botë, Fakulteti i Mjekësisë zënë kryet e vendit, si i veçantë, veprimtaria e të cilit është e ndjekur nga shumë specifika:
- Numri i madh i studentëve në fakultetet: Mjekësi e Përgjithshme; Fizioterapi; Infermieri Stomatologji dhe Farmaci.
- Kohëzgjatja mesatare e studimeve 5 deri 8 vite;

- Numri i madh i lëndëve para klinike e klinike (60- 100);
- Numri tejet i madh i personelit mësimor – shkencor, për një lëndë mësimore ligjërojnë dhe vlerësojnë (3 – 10) mësimdhënës;
- Numri i madh i lëndëve klinike të përcjella me praktikë të ngjeshur profesionale nga një numër disa fish më i madh i asistentëve dhe laborantëve;
- Organizimi dhe udhëheqja e Qendrës Klinike Universitare së bashku me specializime të kandidatëve stazhierë e të tjera .

Tashmë Fakulteti i Mjekësisë pas një veprimtarie të suksesshme 40 vjeçare ka arritur fazën e pjekurisë shumëdimensionale për tu shndërruar në Universitet të Mjekësisë. Kjo aq më parë, kur nga e kaluara, “njerëzit e lapsit” i kanë të freskëta akuzat zënkat dhe prapaskenat e ndërsjella në relacionin: Rektorati i UP-Fakulteti i Mjekësisë (por jo edhe me të tjerët!), lidhur me “ Plagjiatorët” e titujve shkencorë, përkatësisht librave universitarë, kur kishte edhe largime të përkohshme nga puna (në stilin:”Unë po bëhem sikur po punojë, ti po shtireshe sikur të paguaj!). Fakulteti i Mjekësisë do duhej vetëm për vetëm, t’iu gjejë zgjidhje “malit të problemeve”; nga asistentët praktikantë për lëndë klinike (me sukses mesatar) deri te “thirrja për ndihmë” e kuadrit të afirmuar universitar, i cili punon dhe vepron gjithandej nëpër Evropë e më gjerë.

- Krejt në fund, parashtrohen pyetjet; **Ku ishim, nga shkuam dhe ku arritëm?**

Padyshim deri në vitet '90 të shekullit të kaluar, Shkolla e jonë e Lartë ishte plotësisht e krahasueshme me shkollat tjera të larta në Ballkan dhe më gjerë. Aktualisht, cilësia e studimeve në UP mbetet për tu dëshiruar!

Kosova e pasluftës mbi supet e saja mbanë shkallë marramendëse papunësie. Por kjo situatë nuk i jep të drejtë askujt të planifikojë që shkallën e lartë të papunësisë të të rinjve “ta zbutë” duke iu siguruar nga “një vend” në fakultet (edhe pse logjikisht të gjithë aty nuk e kanë vendin!). E dimë që, për studime nuk ekziston as dëshira, as vullneti, as gatishmëria e shumë nxënësve, por as shkalla e inteligjencës së një pjese jo të vogël të tyre dhe së fundi as “buxheti familjar” i shumicës prej tyre, i ndodhur aktualisht në kufij ekzistencial. Këto “kategori” detyrohen të “shkojnë në studime”. Kjo nuk është e drejtë dhe “humane” por nuk është as “zgjidhje e mençur” dhe si e tillë paraqet “perceptim invers të realitetit”.

Nëse studentët kosovarë nuk aftësohen ta përballojnë tregun evropian të punës çfarë kuptimi ka, nëse ata që e mbarojnë mbasin me diplomë fakulteti në xhep, të cilat nuk pranohen si të barasvlershme me diplomat simotra gjetkë, ndërsa për tregun vendorë paraqesin “tepricë teknologjike”?!

Në mbështetje të globalizmit, UNESCO ka arritur t’i artikulojë katër shtyllat e para të arsimit:

- Të mësuarit për të ditur,**
- Të mësuarit për të vepruar,**
- Të mësuarit për të qenë,**
- Të mësuarit për të jetuar së bashku me të tjerët.**

Përveç këtyre, më pas UNICEF-i zbuloi edhe shtyllën e pestë:

- Të mësuarit për ta transformuar vetveten dhe shoqërinë .**

“E përkthyer” do të thotë: “Nuk bën gjithnjë të pajtohemi me realitetin dhe t’i përshtatemi atij, por duhet bërë përpjekje për ta transformuar atë, duke qenë të autorizuar (në emër të arsimimit), që ta bëjmë këtë”.

Ja po këtu, kemi gabuar “të gjithë” punonjësit universitarë! Ka të ngjarë edhe të mos dinim që ekziston shtylla e pestë e arsimimit~!

Si t’i rikthehet “nami” që e kishte dikur Universiteti i Prishtinës? Si të bëhet emër i njohur ta zëmë siç është Universiteti i Gracit (university of Graz) Universiteti i Sorbonës (University de Sorbone), Universiteti i Harvardit (Harvard University), Universiteti i Lozanës (University of Lausanne), ... e shumë tjerë, diplomat e të cilëve janë të besueshme dhe pranohen kudo në botë dhe ku kërkesat e studentëve të huaj për të studiuar aty, gjithnjë janë në rritje e sipër?!

Nuk është se sot UP rrezikon të mbyllet, por, po qe se nëpërmjet Reformave (të projektuara) për “koka të ndërtuara mirë” (arsimi fillor dhe i mesëm), ku mbi ato të ngritën “kokat e mbushura mirë” (arsimi universitar), nuk i rikthehet “nami i viteve ’70-’80 të shekullit të kaluar”, atëherë degradimi i UP nuk do ketë të ndalur. - “Rrënimi eventual i UP është si shkelja mbi një shenjtëri”.

P.S. Në punim nuk arrita t’i shmangja refleksionet nga tonet e ngjyrat e një marazi personal. Çështja në fjalë nuk është hiç maraz, meqenëse artikullshkruesit nuk i mungon “përmendorja e përmendoreve”.

Punimi u shkrua me rastin e kompletimit të dokumentacionit për pensionim .

2. dhjetor. 2010.